



sondazh i opinionit publik

2017

BESIMI NË QEVERISJE



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Sondazh i opinionit publik

BESIMI në QEVERISJE 2017



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Empowered lives.
Resilient nations.

© 2018 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1 1017

Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@idmalbania.org

Adresa në internet: www.idmalbania.org

Autorët:

Aleka Papa

Marsela Dauti, PhD

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) ose të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

GJETJET KRYESORE

BESIMI NË INSTITUCIONE:

- Në vitin 2017, institucionet kombëtare që gëzojnë besimin e më shumë se gjysmës së të anketuarve përfshijnë: **Institucionet Fetare** (76%), **Forcat e Armatosura** (63%), **Institucionet e Arsimit Publik** (63%), **Organizatat e Shoqërisë Civile** (57%), **Media** (54%), **Institucionet e Shëndetit Publik** (53%) dhe **Policia e Shtetit** (53%).
- Institucionet kombëtare që kanë marrë vlerësime më të ulta besimi nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: **Qeveria vendore** (49%), **Qeveria** (47%), **Parlamenti** (34%), **Presidenti** (33%), **Prokuroria** (22%), **Gjykatat** (21%) dhe **Partitë Politike** (21%).
- Që prej vitit 2014, përqindja e të anketuarve që kanë besim tek **Institucionet Fetare** është rritur ndjeshëm nga 44% në 76%. Gjatë vitit 2017, ato kanë shënuar rritjen më të lartë në nivelin e besimit të përgjithshëm (18 pikë përqindje).
- **Shoqëria Civile** shënon një rritje prej 11 pikë përqindje për 2017 dhe vazhdon të jetë në rritje që nga vlerësimi i saj besueshmërisë prej 34% në vitin 2014.
- Për vitin 2017, **Parlamenti** është në rritje me 7 pikë përqindje në krahasim me vitin 2016.
- **Partitë politike** janë në rënie (2 pikë përqindje) dhe për të pestin vit radhazi renditen si më pak të besuara.
- **Media** ka shënuar një rënie prej 4 pikë përqindje për vitin 2017. Të pyetur mbi kredibilitetin e raportimit në media, vetëm një në çdo dy të anketuar (50%) mendojnë se informacioni i dhënë nga media është i saktë dhe i vërtetë.
- Në ndryshim me institucionet kombëtare, institucionet/organizatat ndërkombëtare - **BE** (85%), **OKB** (85%) dhe **NATO** (84%) - renditen si institucionet më të besuara për të pestin vit radhazi.
- Pavarësisht shpresave të mëdha për një ndikim të mundshëm pozitiv të **Reformës në Drejtësi**, perceptimet për zbatimin me korrektësi të Reformës në praktikë vazhdojnë të jenë të ndara, me 43% e të anketuarve që besojnë se Reforma në Drejtësi do të zbatohet me korrektësi, ndërkohë që 38% besojnë të kundërtën. Numri i të anketuarve që shprehen të pasigurt është rritur me 8 pikë përqindje që nga viti i kaluar.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA:

- Në përgjithësi, perceptimet mbi **transparencën** e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor kanë ndryshuar pak në vitet e fundit; të anketuarit vlerësojnë më lart bashkitë e tyre krahasuar me qeverisjen qendrore, edhe pse vlerësimet pozitive qëndrojnë nën 50%.
- **Kontrolli i Lartë i Shtetit** (KLSH) është perceptuar si institucioni që ka pasur rolin më të madh në bërjen e qeverisë të përgjegjshme gjatë vitit 2017 (67%), ndjekur nga Media (65%) dhe Parlamenti (63%).
- Krahasuar me 2016, **Parlamenti** është perceptuar se ka një rol në rritje në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (rritje me 11 pikë përqindje), i ndjekur nga **Sindikatat** (7 pikë përqindje) dhe **Shoqëria Civile** (5 pikë përqindje).
- Pjesa më e madhe e të anketuarve mendon se nisma e hapjeve të **dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit** është e dobishme për realizimin me sukses të punës nga institucionet publike në të ardhmen (67%), sjell drejtësinë e nevojshme (65%) dhe kontribuon në përmirësimin e kohezionit social (60%).

KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE:

- Të dhënat tregojnë një mospërputhje të dukshme midis perceptimeve mbi përhapjen e korrupsionit dhe përvojave personale të përballjes me fenomenin.
- Ndërkohë që më shumë se 8 nga 10 të anketuar e konsiderojnë **korruptionin e nivelit të ulët** (87%) dhe **të lartë** (88%) si të përhapur ose shumë të përhapur në Shqipëri, vetëm 21% e tyre raportojnë se **kanë qenë dëshmitarë** të të paktën një **rasti korruptiv** në qeverisjen e tyre vendore krahasuar me 15% në qeverisjen qendrore.
- Krahasuar me vitin 2016, për vitin 2017 shifrat e përballjes personale me korruptionin në qeverisjen vendore janë rritur me 6 pikë përqindje, ndërsa për qeverisjen qendrore me 5 pikë përqindje.
- Të anketuarit kanë më pak besim në **ndjekjen penale të rasteve të korruptionit të nivelit të lartë** (25%) krahasuar me rastet e korruptionit të nivelit të ulët (36%).
- Të pyetur përmes një pyetjeje të hapur, 21% e të anketuarve konsiderojnë **Gjykatat** si institucioni më i korruptuar për 2017 të ndjekur nga **Qeveria** (16%), **Institucionet e Shëndetit Publik** (14%) dhe **Parlamenti** (9%).

NDIKIMI POLITIK:

- 72% e të anketuarve i perceptojnë **Gjykatat** si më të prekshme ndaj ndikimit politik, ndjekur nga **Prokuroria** me 69% dhe **Policia e Shtetit** me 49%.
- Institucionet fetare perceptohen si më të pavarurat nga ndikimi politik (9%), të ndjekura nga Organizatat e Shoqërisë Civile (26%).

ANGAZHIMI QYTETAR:

- 36% e të anketuarve raportojnë se kanë **mundësi** të mjaftueshme për të marrë pjesë në **vendimmarrjen** në nivel vendor. 28% e të anketuarve raportojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike në nivel qendror.
- 15% e të anketuarve deklarojnë se kanë **marrë pjesë** në **takime konsultative** në nivel vendor, ndërkohë vetëm 10% e të anketuarve raportojnë se kanë marrë pjesë në takimet konsultative të organizuara në nivel qendror.
- 67% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën “Dëgjuesat publike lokale janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet bashkiake”. Në krahasim me vitin 2016, ka një rritje me 10 pikë përqindje të anketuarve që bien dakord.
- Pjesa dërrmuese e të anketuarve, 80% raportojnë se nuk kanë marrë pjesë në demonstrata/tubime ose kanë nënshkruar një peticion gjatë vitit 2017.

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE TIK:

- Shërbimet publike që janë vlerësuar më mirë nga më shumë se gjysma e të anketuarve përfshijnë **furnizimin me ujë të pijshëm** (56%), shërbimet **e pastrimit** (57%), shërbimet **e emergjencave** (53%) dhe shërbimet **e arsimit publik** (54%).
- Shërbimet publike që janë vlerësuar më pak nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë **shërbimet e punësimit** (74%) dhe **gjykatat** (73%) të ndjekura nga shërbimet e **shëndetit publik** (57%) dhe shërbimet **sociale** (55%).
- 15% e të anketuarve raportojnë se kanë dorëzuar një **ankesë pranë institucioneve përkatëse** në lidhje me një shërbim të marrë gjatë vitit 2017. 37% e të anketuarve raportojnë se ankesa e tyre është adresuar. Një përqindje më e lartë (44%), raporton se ankesa e tyre nuk është adresuar.
- 47% e të anketuarve raportojnë se institucionet nuk “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat e qytetarëve.
- 51% e të anketuarve shprehen se nuk ndihen **të sigurt** në jetën e tyre të përditshme. Pjesa më e madhe e të anketuarve raportojnë si faktorë kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë kriminalitetin (58%), pasigurinë për punën (42%) dhe drejtësinë jo të plotë (32%).
- 39% e të anketuarve janë në dijeni nëse bashkia e tyre ka **faqe interneti**. 52% shprehen se nuk e dinë nëse bashkia ka një faqe interneti. 67% e të anketuarve që janë në dijeni nuk e përdorin faqen e bashkisë.

GJINIA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE:

- 65% e të anketuarve besojnë se në shoqërinë shqiptare ka **barazi** midis burrave dhe grave, ndërkohë 34% nuk janë dakord. Gratë kanë më pak gjasa që të pajtohen me këtë deklaratë sesa burrat.
- 74% e të anketuarve besojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe **etikë** grave dhe burrave, ndërkohë 25% nuk janë dakord. Përsëri, gratë kanë më pak gjasa që të pajtohen me deklaratën sesa burrat.
- 12% e të anketuarve raportojnë se janë **trajtuar ndryshe** nga një institucion apo nëpunës civil për shak të karakteristikave të tyre personale si gjinia, mosha, përkatësia etnike, orientimi seksual apo aftësia e kufizuar.
- 26% e të anketuarve deklarojnë se janë të kënaqur me numrin aktual të grave në këshillin e tyre bashkiak, ndërkohë që 67% nuk e dinë. 7% thonë se janë të kënaqur.
- 69% e të anketuarve shprehen se rritja e numrit të grave në këshillin e tyre bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.

PASQYRA E LËNDËS

GJETJET KRYESORE	3
PASQYRA E LËNDËS	7
HYRJE	8
Metodologjia	9
Qasja	9
Kufizimet	9
DEMOGRAFIA E KAMPIONIT	10
GJETJET	14
Besimi në institucione	14
Transparenca dhe llogaridhënia	26
Korrupsioni në institucionet publike	32
Ndikimi i interesave politikë	38
Angazhimi qytetar	40
Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	47
Performanca e institucioneve publike	54
TIK (përdorimi i teknologjisë)	55
Gjinia dhe përfshirja sociale	59
REFERENCAT	66
Shtojca 1: Njësitë administrative	67
Shtojca 2: Karakteristikat e kampionit 2013-2017	70
POSHTËSHËNIME	71

1. HYRJE

Një nga sfidat e zakonshme me të cilën përballet qeverisja në botë është edhe besimi i ulët dhe në rënie tek qeveritë kombëtare. Besimi tek qeveria dhe tek institucionet është në thelb të kontratës shoqërore funksionale midis një qeverie dhe shoqërisë, me të drejta dhe detyra të ndërsjella. Burrat dhe gratë e një vendi presin që qeveritë e tyre do të mbajnë premtimet dhe të punojnë në interesat e tyre. Përgjatë vendeve, ka një interes në rritje për matjen e besimit institucional. Përveç se është i rëndësishëm në matjen e mirëqënies, të kuptuarit e besimit institucional është thelbësor në të kuptuarit e efektivitetit të qeverisë dhe funksionimit të sistemeve demokratike.

Ky është viti i pestë radhazi (2013-2017) që ky Sondazh i Opinionit po zhvillohet, bazuar në një metodologji, pyetësor dhe mbulim kombëtar të ngjashëm. Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë periudhës 17-30 nëntor 2017 në 61 bashkitë e Shqipërisë. Qëllimi kryesor i sondazhit është shqyrtimi i perceptimit publik dhe qëndrimit të qytetarëve në çështje si: besimi në institucionet publike, transparencja dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i përfshirjes qytetare në politikëbërje dhe vendimmarrje, kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave për mbrojtjen nga diskriminimi.

Raporti është i organizuar në 9 seksione kryesore: Besimi në institucione, Transparenca dhe llogaridhënia, Korrupsioni në institucionet publike, Ndikimi politik në punën e institucioneve, Angazhimi qytetar, Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike, Performanca e institucioneve publike, Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe Gjinia dhe përfshirja sociale.

Sondazhi i Opinionit është i rëndësishëm në kuadrin e monitorimit të reformave madhore të ndërmarra nga qeveria shqiptare, të drejtuara tek institucionet publike që mund të ofrojnë shërbime cilësore, drejtësi dhe kohezion social, politika ekonomike të drejta etj. Për më tepër, të dhënat e mbledhura çdo vit mbështesin vlerësimin e performancës së vendit dhe zbatimin të angazhimeve në nivel ndërkombëtar si Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (PQH) dhe Axhenda 2030: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Që prej vitit 2013, Sondazhi i Opinionit ka evoluar për të mbetur relevant dhe në kohë me pyetje të reja, të cilat nuk kanë ndikuar në krahasueshmërinë dhe interpretimin e trendeve përgjatë viteve. Raporti i këtij viti ofron perspektiva të reja në çështje të rëndësishme si reforma në drejtësi dhe përfshirja sociale.

2. METODOLOGJIA

2.1 QASJA

Në Sondazhin e Opinionit është përdorur përfaqja e kampionimit me kuota për të përzgjedhur një numër të barabartë të anketuarish në secilën prej 61 bashkive në vend (n=27). Ndërkohë, kuota kontrolli (quota controls) janë përdorur për përfaqësimin gjinor dhe klasifikimin urban-rural. Me përzgjedhjen e kuotave të barabarta për secilën bashki, është synuar përfshirja e një larmie të madhe profilesh të të anketuarve në nivel kombëtar në lidhje me moshën e tyre, nivelin arsimor, statusin e punësimit, por edhe vulnerabilitetit. Megjithatë, duke qenë se ka vetëm dy kuota kontrolli, karakteristikat e tjera të kampionit janë të ndryshueshme. Për karakteristikat socio-demografike të të anketuarve që prej vitit 2013, referojuni shtojcës.

Instrumenti i sondazhit, pyetësi, ka përfshirë të njëjtat module bazë mbi besimin, transparencën, llogaridhënien, angazhimin qytetar dhe TIK që prej 2013, edhe pse përmbajtja e tij është shqyrtuar çdo vit nga një panel ekspertësh në fushat e qeverisjes së mirë dhe shkencave sociale për të qenë në linjë me zhvillimet e fundit në nivel kombëtar dhe në diskursin publik. Për vitin 2017, është ri-përfshirë një seksion mbi Performancën e institucioneve publike dhe janë shtuar pyetje të reja në seksionet e Transparencës dhe Llogaridhënies, Korrupsionit në institucionet publike dhe Angazhimit qytetar.

Në Shtojcën 1 është lista e plotë e njësive administrative të përfshira në sondazh. Dymbëdhjetë skuadra me anketues të trajnuar administrojnë pyetësin në terren nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë duke përdorur metodën PAPI. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan për të paraqitur statistikat përshkruese dhe relacionale, duke përdorur STATA 12.0.

2.2 KUFIZIMET

Rezultatet e Sondazhit të Opinionit përvijojnë një panoramë të perceptimeve dhe qëndrimeve publike dhe shfaqin trendet në kohë, megjithatë ato nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën. Qëllimi final i sondazhit është t'i jepet "zëri" të gjithë qytetarëve pavarësisht afritë së tyre me qeverinë qendrore dhe të eksplorojnë trendet vjetore të perceptimit publik.


3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

U anketuan në të gjithë vendin gjithsej 1647 qytetarë shqiptarë të moshës 18 vjeç e lart. Të dhënat kryesore demografike të kampionit përfundimtar të të anketuarve jepen më poshtë.

Duke qenë se janë përdorur kuota kontrolli si për gjininë dhe klasifikimin urban-rural, kampioni ka një përfaqësim gjinor dhe klasifikim urban-rural të balancuar. Kampioni ka 51% burra dhe 49% gra. Gjysma e popullatës së kampionit banon në zona urbane dhe gjysma në zona rurale. (Shih grafikun 1 dhe grafikun 2).

Fig. 1


Përfaqësimi sipas gjinisë



Baza: N=1644

Fig. 2

Klasifikimi gjeografik




Baza: N=1644

Mosha mesatare e të anketuarve është 41.22 vjeç (DS=15.46)¹ në një interval moshe nga 18-91 vjeç. Për shpërndarjen sipas grup-moshave të ndryshme shih grafikun 3.

Fig. 3

Grupmoshat




Baza: N=1632

Për sa i përket nivelit të arsimit, gjysma e të anketuarve (50%) kanë përfunduar vetëm shkollën e mesme, ndërkohë që rreth 28% prej tyre ose janë në procesin e marrjes së një diplome universitare/pasuniversitare ose e kanë përfunduar universitetin. Rreth 17% e kampionit ka kryer vetëm arsimin e detyrueshëm.

Fig. 4

Niveli arsimor



Baza: N=1619

Në lidhje me statusin e punësimit, 46% e të anketuarve ishin të punësuar në momentin e intervistimit (nga ku 29% ishin të punësuar në sektorin publik, ndërsa 71% në sektorin privat). 7% e të anketuarve ishin studentë, ndërsa 12% pensionistë.


Tabela 2 Statusi i punësimit (Baza: N=1632)

I/E punësuar	46%
Sektori publik	29%
Sektori privat	71%
<i>Totali</i>	<i>100%</i>
I/E papunë	34%
Student	7%
Pensionist	12%
Tjetër	1%
Totali	100%

Grafiku 5 paraqet shpërndarjen e të ardhurave mujore individuale të të anketuarëve.

Fig. 5

Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)




Baza: N=1572

Vetëm 7% e të anketuarve raportuan se kishin të paktën një aftësi të kufizuar, prej ku rreth 75% deklaruan se përfitonin nga pensioni i invaliditetit. 55% e të anketuarve që u vetë-raportuan me aftësi të kufizuar ishin burra, ndërkohë që 56% jetonin në zonat urbane.

Fig. 6

Keni ndonjë aftësi të kufizuar?



Baza: N=1623

Më pak se 1 në 10 të anketuar (9%) deklaruan se i përkisnin një pakice kombëtare. Nga kjo pjesë, 35% e deklaruan veten si grekë, 26% si romë dhe 17% si maqedonas. Shih tabelën 2 për shpërndarjen e kampionit.

Tabela 3 A i përkisni ndonjë pakice kombëtare? (Baza: N=1624)

	PO	9%
	Greke	35% (n=52)
	Maqedonase	17% (n=26)
	Arumune	1% (n=1)
	Rome	26% (n=38)
	Egjiptiane	9% (n=14)
	Boshnjakë	3% (n=4)
	Bullgar	1% (n=1)
	Refuzim	8% (n=12)
	Totali	100% (n=148)
	JO	90%
	REFUZIM	1%
	Totali	100%

4. GJETJET

4.1 BESIMI NË INSTITUCIONE

Besimi në institucione apo besimi institucional nënkupton pritshmërinë individuale që një institucion i caktuar do të gjenerojë rezultate pozitive (Levi dhe Stoker 2000). Besimi në institucionet publike, në veçanti, vlerësohet si i rëndësishëm për suksesin e një game të gjerë të politikave publike, programeve dhe rregulloreve që janë në varësi të bashkëpunimit me qytetarët. Mungesa e besimit kompromenton vullnetin e qytetarëve dhe biznesit për t'iu përgjigjur politikave publike, duke penguar kështu zhvillimin e qëndrueshëm (OECD 2013). Besimi në institucionet publike konsiderohet të jetë funksion i vlerësimit institucional, konsideratave politike të qytetarëve², cilësisë së rezultateve të politikave, raportimit të medias,³ perceptimeve rreth ndryshimeve sociale dhe kulturore, por edhe karakteristikave socio-demografike të tilla si, mosha, arsimit, të ardhurat dhe gjinia (Hetherington 1998).

“Besimi në institucione” përfaqëson një nga modulet kryesore të Sondazhit të Opinioneve. Të anketuarve u kërkohet që të vlerësojnë në një shkallë me katër pikë, nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam fare besim), sesa ata i besojnë institucioneve kryesore publike dhe politike në nivel qendror dhe vendor, si dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në vend⁴. Kur të anketuarit shprehin nivelin e tyre të besimit në institucione të caktuara, ne supozojmë se mendimi i tyre bazohet në imazhet institucionale që ata kanë ndërtuar, çka përkon me kriteret e përgjithshme ose normative që ata përdorin në vlerësimin e tyre. Supozimi themelor këtu është se për të ndërtuar përfytyrimet e tyre lidhur me institucionet, qytetarët zhvillojnë pritshmëritë e tyre dhe nuk nevojitet që të dinë në detaje se si institucionet specifike janë projektuar dhe/apo funksionojnë.

Në vitin 2017, institucionet kombëtare që gëzojnë besimin⁵ e më shumë se gjysmës së të anketuarve përfshijnë: Institucionet Fetare (76%), Forcat e Armatosura (63%), Institucionet e Arsimit Publik (63%), Organizatat e Shoqërisë Civile (57%), Media (54%), Institucionet e Shëndetit Publik (53%) dhe Policia e Shtetit (53%).

Institucionet Fetare renditen si më të besuarat, me më shumë se dy të tretat e të anketuarve (76%) që shprehen se “kanë shumë besim” (27%) ose “kanë besim” (49%). Edhe nëse marrim në konsideratë vetëm kategorinë “kam shumë besim”, Institucionet Fetare gëzojnë nivelin më të lartë të besueshmërisë (27%).

Forcat e Armatosura dhe Institucionet e Arsimit Publik renditen në vend të dytë për nga shkalla e besimit duke gëzuar besimin e 63% të popullsisë së anketuar. Megjithatë, Forcat e Armatosura gëzojnë përqindjen më të madhe të të anketuarve që shprehen se “kanë shumë

besim” (15%) në krahasim me Institucionet e Arsimit Publik (9%).

Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC-të) besohen nga 57% e popullsisë së anketuar, të ndjekura nga Media me 54%. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve (53%) beson në Institucionet e Shëndetit Publik dhe në Policinë e Shtetit.

Institucionet kombëtare që kanë marrë vlerësime më të ulta besimi nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: Qeveria vendore (49%), Qeveria (47%), Parlamenti (34%), Presidenti (33%), Prokuroria (22%), Gjykatat (21%) dhe Partitë Politike (21%).

Bashkitë gëzojnë besim më të madh (49%) sesa Qeveria (47%). Megjithatë, përqindja e të anketuarve që shprehen se “kanë shumë besim” është e njëjtë (9%).

Pushteti ekzekutiv, në krahasim me atë legjislativ dhe gjyqësor, gëzon një nivel më të lartë besimi nga të anketuarit. Parlamenti besohet nga vetëm një e treta e të anketuarve (34%), ndërsa Gjykatat (21%) dhe Partitë Politike renditen si institucionet më pak të besuara (21%).

Në ndryshim me institucionet kombëtare, institucionet/organizatat ndërkombëtare si BE, OKB dhe NATO renditen si institucionet më të besuara, duke gëzuar besimin e më shumë se 4 në 5 të anketuar. (respektivisht 85%, 85%, 84% të besimit).

Krahasimi Socio-Demografik

Në këtë pjesë shqyrtohet nëse besimi në institucione specifike varion midis segmenteve të ndryshme socio-ekonomike të popullsisë së anketuar.

Në një nivel agregat,⁶ duket se në përgjithësi nuk ka shumë ndryshim në besueshmërinë institucionale në varësi të gjinisë. Megjithatë, gratë (57%) kanë më shumë gjasa se burrat (51%) që të besojnë median.

Të anketuarit nga pjesa më e vjetër e demografisë priren të raportojnë nivele më të larta të besimit në krahasim me segmentet më të reja në moshë. Të anketuarit në grupmoshën “Mbi 66 vjeç” kanë më shumë besim tek Institucionet Fetare (87%), Forcat e Armatosura (69%), Policia (66%), OShC-të (62%), Media (59%) Institucionet e Shëndetit Publik (58%), Qeveria Vendore (57%), dhe Qeveria Qendrore (53%).


Nivelet e raportuara të besimit gjithashtu kanë më shumë gjasa të rriten me nivelin e arsimit të të anketuarve. Të anketuarit me arsim universitar kanë më shumë besim tek Forcat e Armatosura (67%), OShC-të (62%), Institucionet e Shëndetit Publik (57%), Qeveria Vendore (54%) dhe Qeveria Qendrore (51%). Një përjashtim bëjnë mediat, ku marrëdhënia paraqitet e përmbysur: 60% e të anketuarve me arsim bazë⁷ i besojnë Medias, në krahasim me 50% me diplomë universitare ose më lart.

Për sa i përket situatës së punësimit, pjesa e punësuar e demografisë priret të ketë më besim dhe, brenda kësaj kategorie, ky perceptim është më i theksuar tek të punësuarit në sektorin publik. Klasifikimi urban-rural nuk duket të luajë një rol të rëndësishëm.

Tabela 3 përmbledh rezultatet.

Fig.7

Besimi institucional 2017



Baza: N=1647

Tabela 4 Tabela e analizës relacionale “Kam shumë besim” ose “Kam besim”

Qeveria	Qev Ven.	Presi-denti	Par-lam.	Proku-rori	Gjy-ka-tat	Policia	Ush-tria	Par-titë Poli-tike	Shën-detësia	Arsimi	Me-dia	Ins. Fetare	OS- HC-të	CSOs
TOTALI (besimi)	47%	49%	33%	34%	22%	21%	53%	63%	21%	53%	63%	54%	76%	57%
Gjinia														
Meshkuj	47%	48%	34%	35%	21%	19%	55%	64%	23%	52%	62%	51%	77%	55%
Femra	46%	51%	31%	34%	25%	21%	50%	61%	19%	54%	63%	57%	76%	60%
Mosha														
18-25	40%	45%	35%	32%	28%	26%	50%	61%	17%	51%	57%	49%	71%	55%
26-35	50%	53%	34%	33%	23%	20%	50%	67%	21%	54%	64%	53%	79%	62%
36-45	43%	46%	32%	34%	19%	16%	51%	57%	24%	51%	61%	53%	76%	53%
46-55	44%	48%	28%	35%	21%	18%	51%	60%	20%	51%	65%	56%	75%	54%
56-65	48%	49%	32%	40%	22%	18%	56%	63%	20%	57%	64%	56%	75%	60%
Over 66	53%	57%	39%	33%	25%	25%	66%	69%	23%	58%	66%	59%	87%	62%
Niveli i arsimit														
Arsim bazë	40%	42%	31%	28%	23%	22%	46%	51%	21%	50%	58%	60%	75%	56%
Shkollë e mesme	46%	50%	31%	35%	21%	19%	56%	66%	20%	53%	64%	54%	77%	56%
Universitet	51%	54%	36%	37%	26%	21%	52%	67%	23%	57%	63%	50%	76%	62%
Statusi i punësimit														
Totali	51%	56%	37%	40%	23%	20%	54%	65%	24%	58%	68%	50%	77%	57%
Të punësuar	67%	72%	45%	48%	26%	23%	62%	73%	32%	68%	75%	51%	74%	61%
Të papunë	45%	49%	34%	36%	32%	19%	51%	62%	20%	55%	66%	50%	78%	55%
Studentë	36%	39%	26%	26%	20%	17%	46%	57%	17%	45%	55%	58%	74%	55%
Pensionistë	44%	45%	31%	36%	30%	26%	53%	63%	19%	53%	61%	55%	71%	62%
55%	57%	39%	37%	37%	26%	27%	65%	70%	26%	60%	67%	63%	85%	65%
Zona														
Urbane	45%	48%	30%	32%	22%	21%	53%	62%	21%	55%	63%	51%	75%	58%
Rurale	48%	50%	35%	36%	23%	19%	52%	63%	21%	52%	62%	56%	77%	56%

Shënim: Shifrat janë rumbullakosur në përqindjen më të afërt

Krahasimi në kohë

Të dhënat për 2017 tregojnë se nga dymbëdhjetë institucionet kombëtare të listuara⁸, katër prej tyre kanë shënuar rënie në besimin e përgjithshëm; një institucion është në stanjacion, ndërsa shtatë kanë shënuar rritje në nivelet e përgjithshme të besimit.


Policia e Shtetit, për herë të parë që prej vitit 2013, ka përmbysur trendin e saj pozitiv në rritje dhe shënon një rënie prej 8 pikë përqindje në besim; besimi në Polici është 53% për vitin 2017. Media ka shënuar një rënie prej 4 pikë përqindje për vitin 2017. Besimi në institucionin e Presidentit, për herë të parë që nga viti 2014, është në rënie (3 p.p). Partitë Politike po ashtu janë në rënie (2 p.p) dhe, për të pestin vit radhazi, renditen si më pak të besuarat.

Përqindja e të anketuarve që kanë besim tek bashkia e tyre qëndron e pandryshuar në 49%.

Në vitet e fundit (që nga viti 2014), përqindja e të anketuarve që besojnë tek Institucionet Fetare është rritur ndjeshëm. Gjatë vitit 2017, ato kanë regjistruar rritjen më të lartë në nivelin e besimit të përgjithshëm (18 p.p) dhe qëndrojnë në 76%. Shoqëria Civile gjithashtu regjistron një rritje prej 11 pikë përqindjeje dhe vazhdon të jetë në rritje që nga vlerësimi i besueshmërisë prej 34% në vitin 2014. Në krahasim me vitin e kaluar, për vitin 2017, më shumë të anketuar i besojnë Forcave të Armatosura (63%) sesa Policisë së Shtetit (53%). Parlamenti është gjithashtu në rritje me 7 pikë përqindje.

Fig. 8

Ndryshimi i besimit agregat (p.p) 2016-2017



Shih tabelën 4 për shpërndarjen e ndryshimit të besimit në bazë të kategorive “Kam shumë besim” dhe “Kam besim”.


Tabela 4 Ndryshimi në kategoritë e besimit (pikë përqindjeje: p.p) 2016-2017

	Ndryshim në “Kam shumë besim”	Ndryshim në “Kam besim”	Ndryshim në besimin agregat
Inst. Fetare	5%	13%	18%
Shoqëria Civile	0%	11%	11%
Forcat e Armatosura	3%	5%	8%
Parlamenti	-3%	10%	7%
OKB	2%	3%	5%
NATO	2%	3%	5%
BE	3%	2%	5%
Inst. e Arsimit Publik	0%	4%	4%
Inst. e Shëndetit Publik	-2%	5%	3%
Qeveria qendrore	-2%	5%	3%
Bashkia	-2%	2%	0%
Partitë politike	-2%	0%	-2%
Presidenti	-3%	0%	-3%
Media	-2%	-2%	-4%
Policia	-2%	-6%	-8%

Duke u zhvendosur nga institucionet kombëtare, besimi tek organizatat ndërkombëtare është rritur në të njëjtin nivel gjatë vitit 2017 (5 p.p) ndërsa Bashkimi Evropian dhe NATO qëndrojnë në vlerësimin e tyre më të lartë që nga viti 2013. Shih Tab.5 për shpërndarjen e rezultateve që nga viti 2013.

Fig. 9

Besimi institucional (2013-2017)






Tabela 5 Besimi Institucional (2013-2017)

	2013	2014	2015	2016	2017
Qeveria	30%	37%	34%	44%	47%
Qeveria vendore	N/A	N/A	N/A	49%	49%
Presidenti	35%	25%	29%	36%	33%
Parlamenti	24%	29%	22%	27%	34%
Gjykatat	19%	18%	17%	23%	N/A
Prokuroria	N/A	N/A	N/A	N/A	22%
Gjykatat	N/A	N/A	N/A	N/A	21%
Policia	37%	41%	46%	61%	53%
Forcat e armatosura	51%	44%	46%	55%	63%
Partitë politike	17%	19%	15%	23%	21%
Inst. e shëndetit publik	30%	32%	27%	50%	53%
Inst. e arsimit publik	38%	37%	33%	59%	63%
Media	40%	39%	39%	58%	54%
Institucionet fetare	51%	44%	52%	58%	76%
Shoqëria civile	39%	34%	38%	46%	57%
BE	70%	68%	72%	80%	85%
OKB	N/A	N/A	N/A	80%	85%
NATO	74%	71%	74%	79%	84%

Burimi: Sondazhi i Opinioneve 2013-2017

Për vitin e dytë rradhazi, pyetjet bazë lidhur me besimin institucional janë plotësuar me pyetje të tjera – mbi pikëpamjet e publikut në lidhje me temën e Reformës në Drejtësi dhe besueshmërinë tek raportimi i medias.


Reforma në Drejtësi

Gjatë dy viteve të fundit, tema e Reformës në Drejtësi dominoi një pjesë të rëndësishme të diskutimit publik. Në korrik të 2016, ndryshimet kushtetuese lidhur me organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë u miratuan unanimisht, duke nisur një proces të plotë dhe gjithëpërfshirës të reformës së gjyqësorit - e cila është në vazhdim e sipër.

Të dhënat për vitin 2017 ri-theksojnë pritshmërinë e gjerë të publikut rreth ndikimit pozitiv që do të sjellë zbatimi i Reformës në Drejtësi në zhvillimin e vendit, megjithëse përqindja e kësaj pritshmërie pozitive ka rënë nga 71% në 2016 në 66% në 2017. Gjithashtu, më shumë të anketuar shprehen të pasigurtë dhe thonë se “Nuk e dinë” në krahasim me një vit më parë (16% kundrejt 11%).

Fig. 10

Ndikimi pozitiv i Reformës në Drejtësi në zhvillimin e vendit




Baza: N=1644

Pavarësisht shpresave të mëdha për një ndikim të mundshëm pozitiv të saj, perceptimet për zbatimin me korrektësi të Reformës në praktikë vazhdojnë të jenë të ndara. 43% e të anketuarve besojnë se Reforma në Drejtësi do të zbatohet me korrektësi, ndërsa 38% besojnë të kundërtën; 2 në 10 të anketuar (20%) përgjigjen “Nuk e di” - 8 pikë përqindje më shumë nga 12% në vitin 2016.

Fig. 11

Zbatimi me korrektësi i Reformës në Drejtësi



Baza: N=1646


Femrat (23%) kishin më shumë gjasa se meshkujt (16%) të raportonin se “Nuk e dinë” nëse Reforma në Drejtësi do të zbatohet me korrektësi. Gjithashtu, të anketuarit me nivel më të ulët arsimimi (arsimi i detyrueshëm ose më i ulët) (27%) kishin më shumë gjasa të raportonin “nuk e di”. Të anketuarit ishin më të prirur të raportonin se Reforma do të zbatohet nëse ishin të punësuar në sektorin publik (55%).

Media

Edhe në vitin 2017, mediumi më i përdorur nga të anketuarit mbetet televizioni (70%). Më tej, platformat e rrjeteve sociale renditen si mediumi i dytë më popullor (18%) të ndjekura nga portalet (7%) dhe gazetatat (4%).

Fig. 12

Cilën media përdorni më shumë?




Baza: N=1643

Të pyetur mbi kredibilitetin e raportimit në media, vetëm një në çdo dy të anketuar (50%) mendon se informacioni i dhënë nga media është i saktë dhe i vërtetë, në krahasim me 30% të atyre që nuk mendojnë kështu. Më shumë të anketuar (20%) u përgjigjën “nuk e di” në 2017 krahasuar me 2016 (15%).

Fig. 13

A është informacioni që jepet në media i saktë/i vërtetë?



Baza: For 2017, N=1646, for 2016 N=1639

Të anketuarit me arsim të ulët (58%) dhe ata që ishin të punësuar (57%) kishin më shumë gjasa të shpreheshin se informacioni i marrë nga media ishte i saktë.

4.2 TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA


Transparenca

Transparenca konsiderohet si një nga parimet themelore të mirëqeverisjes dhe një parakusht për çdo regjim demokratik. Pavarësisht përdorimit të tepruar të termit, studiuesit dhe akademikët vijojnë të kenë përkufizime të ndryshme për të. Disa prej tyre fokusohen tek ligjet e të drejtës për informimin, disa mbi e-qeverisjen, dhe disa të tjerë përqëndrohen në efektet e transparencës -duke supozuar se ajo gjeneron më shumë besim, më shumë pjesëmarrje dhe një administratë më efikase dhe më pak korrupsion.

Në përgjithësi, perceptimet mbi transparencën e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor kanë ndryshuar pak në vitet e fundit; të anketuarit vijojnë të vlerësojnë më lart bashkitë e tyre krahasuar me qeverisjen qendrore, edhe pse vlerësimet pozitive qëndrojnë nën 50%. Për 2017, 44% e të anketuarve janë plotësisht dakord (7%) ose janë dakord (37%) që bashkia e tyre është transparente (43% në 2016). Ndërkohë, kur pyeten për qeverinë qendrore kjo dakordësi bie në 40% (39% në 2016); 6% janë plotësisht dakord, ndërkohë 34% janë dakord. Shiko grafikun 14.

Fig. 14

Transparenca e qeverisë qendrore dhe bashkisë 2017



Baza: For central government, N=1636, For local government, N=1637 Note: No opinion not shown


Ushtrimi i së drejtës për informim

Një ligj i ri “Për të Drejtën e Informimit” (ligji Nr.119/2014) u miratua në shtator 2014. Ligji rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe synon të nxisë integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Për të dytin vit, Sondazhi i Opinionit, eksploron perceptimet e publikut mbi ushtrimin e të drejtës të informimit.

6 në 10 të anketuar (ose 60%) deklarojnë se e dinë që në Shqipëri ligji garanton të “Drejtën e Informimit”, ndërsa 40% e tyre nuk janë në dijeni të këtij fakti. Këto statistika janë të ngjashme me vitin e kaluar, ku 57% e të anketuarve ishin në dijeni të ligjit krahasuar me 43% që nuk ishin.

Fig. 15

A jeni në dijeni se në Shqipëri “e drejta e informimit” garantohej me ligj?




Baza: N=1630

Të anketuarit të cilët ishin në dijeni se e drejta e informimit është e garantuar me ligj, u pyetën nëse kishin dorëzuar ndonjë kërkesë për informim tek institucionet publike gjatë 2017. Neni 3 i ligjit përcakton se “Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet”. Nga pikëpamja procedurale, kërkesa për informim duhet të bëhet me shkrim dhe të dorëzohet dorazi, me postë ose postë elektronike, me identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij/saj. Autoriteti publik të cilit i bëhet kërkesa, trajton kërkesën për informim jo më vonë se 10 ditë pune që nga dita e dorëzimit.⁹

Fig. 16

A keni paraqitur ndonjë kërkesë për informacion në ndonjë institucion publik 2017?




Baza: N=962

Për 2017, më pak se çereku i të anketuarve (22% ku n=207)¹⁰ deklarojnë se kanë dorëzuar një kërkesë për informim tek një autoritet publik (23% në 2016) dhe prej tyre, 67% (n=138) shprehen se e kanë marrë informacionin e kërkuar. Shiko grafikët 16 dhe 17.

Fig. 17

Nëse po, a morët informacionin e kërkuar?



Baza: N=205


Llogaridhënia

Njëlljosi me transparencën, koncepti i llogaridhënies është në qendër të teorisë dhe praktikës së mirëqeverisjes për shkak të rëndësisë së saj në parandalimin e abuzimit të pushtetit politik. Të jesh përgjegjës do të thotë të kesh detyrimin të japësh llogari, të shpjegosh dhe justifikosh veprimet e tua në aspektin e kritereve të duhura dhe në detaje të mjaftueshme. Ndërtimi i institucioneve transparente dhe llogaridhënese në të gjitha nivelet është identifikuar dhe si një nga indikatorët e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 16.¹¹

Ne Sondazhin e Opinionit, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin nivelin e llogaridhënies (i.e shpjegimi për veprimet, mosveprimet tek elektorati) i qeverive të tyre vendore dhe qendrore gjatë 2017. Në të njëjtën linjë me gjetjet për transparencën, të intervistuarit i shohin bashkitë e tyre si më llogaridhënese se sa qeveria qendrore, pavarësisht se vlerësimet pozitive qëndrojnë nën 50%. Për bashkitë e tyre, 42% e të anketuarve janë plotësisht dakord (7%) ose dakord (35%) se qeveria e tyre lokale është e përgjegjshme ndërsa shumica (ose 55%) nuk bien dakord me këtë pohim. Përsa i përket qeverisë qendrore, 39% e të anketuarve janë plotësisht dakord (7%) apo dakord (35%) se qeveria qendrore jep llogari, ndërsa shumica (ose 61%) ose nuk janë dakord (41%) ose nuk janë aspak dakord (20%). Shiko grafikun 18 për rezultatet. Këto shifra janë të ngjashme me vitin e kaluar, ku llogaridhënia për qeverinë lokale vlerësohej me 43%, ndërsa për qeverisjen qendrore tek 36%.

Fig. 18

Llogaridhënia e qeverisë qendrore dhe bashkisë 2017




Baza: Për qeverisjen qendrore, N=1635, Për qeverisjen lokale, N=1633. Shënim: Kategoria "nuk kam mendim" nuk është përfshirë

Koncepti i llogaridhënies mund të klasifikohet bazuar në natyrën e llogaridhënies së ushtruar nga/ose personi, grupi apo institucioni që përfaqëson zyrtari publik, duke formuar kështu dy forma kryesore: llogaridhënie horizontale dhe llogaridhënie vertikale. Llogaridhënia horizontale lidhet me aftësinë e institucioneve shtetërore (si legjislativi dhe gjyqësori) për të mbikëqyrur qeverinë duke kërkuar informacion, duke vënë në dyshim zyrtarët dhe ndëshkuar sjelljet e gabuara. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale është mënyra se si qytetarët, media, dhe shoqëria civile kërkojnë të përforcojnë standardet e performancës së mirë tek zyrtarët publik.¹²

Fig. 19

Mekanizmat e llogaridhënies horizontale




Ashtu siç shihet nga grafiku 19, për 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) konsiderohet si institucioni që ka pasur rolin më të madh në bërjen e qeverisë të përgjegjshme (67%), ndjekur nga Parlamenti (63%), Avokati i Popullit (55%), Partitë Opozitare (54%) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (45%).

Përsa i përket mekanizmave të llogaridhënies vertikale, Media perceptohet te ketë rolin kryesor në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (65%), ndjekur nga Shoqëria Civile (51%). Më pak se gjysma e të intervistuarve deklarojnë se Sindikatat (46%) dhe Bizneset (44%) luajnë rol në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Fig. 20


Mekanizmat e llogaridhënies vertikale



Përsa i përket krahasimit me 2016, Parlamenti konsiderohet të ketë një rol në rritje në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (rritje me 11 pikë përqindje), i ndjekur nga Sindikatat (7 pikë përqindje) dhe Shoqëria Civile (5 pikë përqindje). Shiko grafikun 21 për shpërndarjen e rezultateve.

Fig. 21

Ndryshimet në llogaridhënie 2016-2017




Hapja e Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit, i themeluar me ligjin 45/2015, është përgjegjës për administrimin dhe bërjen transparente të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit.¹³ Për 2017, Sondazhi i Opinioneve ka përfshirë një bashkësi pyetjesh për të vlerësuar perceptimin e publikut mbi potencialet e kësaj nisme. Shumica e të intervistuarve mendon se kjo iniciativë është e dobishme për realizimin me sukses të punës nga institucionet publike në të ardhmen (67%), sjell drejtësinë e nevojshme (65%) dhe kontribuon në përmirësimin e kohezionit social (60%). Rreth 2 në 10 të anketuar deklarohen të pasigurt mbi këtë çështje.

Fig. 22

Nisma për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit



4.3 KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Transparency International e përkufizon korrupsionin si abuzimi i pushtetit të dhënë për përfitime personale. Korrupsioni mund të klasifikohet si i madh ose i vogël, në varësi të shumës së parave të humbura në sektorin ku ndodh. Korrupsioni i madh përfshin vendimmarrësit politik dhe zyrtarët e lartë publik të cilët shfrytëzojnë pozicionet e tyre për të marrë ryshfete, përfituar shuma të mëdha parash apo për të përshtatur rregulloret për përfitimin e interesave të tyre private. Ndërkohë, korrupsioni i vogël përfshin zyrtarë publik

të nivelit të mesëm-ulët dhe përgjithësisht cënon anëtarët më të varfër të shoqërisë gjatë ndërveprimeve të tyre me administratën për shërbimet publike (Andvig et al.2001).

Perceptimi i përhapjes së korrupsionit

Si një pyetje e re e përfshirë për herë të parë në Sondazhin e Opinioneve, të intervistuarve iu është kërkuar të vlerësojnë në një shkallë nga 1 (Aspak i përhapur) në 4 (Shumë i përhapur) përhapjen e korrupsionit¹⁴ të nivelit të ulët dhe të lartë në Shqipëri gjatë 2017. Në përgjithësi, të intervistuarit e perceptojnë korrupsionin si të kudondodhur në shoqërinë shqiptare, pavarësisht formës në të cilën ai shfaqet. Shiko Tabelën 6. Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) e shohin korrupsionin e nivelit të ulët si të përhapur ndërsa rreth 33% si shumë të përhapur. Për korrupsionin e nivelit të lartë, 48% e të intervistuarve e shohin si të përhapur. Ndërsa 40% e konsiderojnë atë si shumë të përhapur. Vetëm 9% e të anketuarve e perceptojnë korrupsionin e nivelit të lartë si ose shumë të rrallë (1%) ose deri diku të rrallë (8%).

Tabela 6 Perceptimet mbi korrupsionin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit

	Aspak i përhapur [shumë i rrallë]	Jo i përhapur [deri diku i rrallë]	I përhapur	Shumë i përhapur
Korrupsioni i nivelit të ulët	1%	9%	54%	33%
Korrupsioni i nivelit të lartë	1%	8%	48%	40%
	Kam shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit	Kam besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit	Nuk kam besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit	Nuk kam aspak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit
Korrupsion i nivelit të ulët	6%	30%	39%	23%
Korrupsion i nivelit të lartë	5%	20%	41%	32%

Shënim: Nuk përfshihen refuzimet

Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit

Të dhënat mbi besimin e publikut në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit konfirmojnë besimin e ulët tek sistemi i drejtësisë (Shiko seksionin 4.1 Besimi në Institucione). Për më tepër, të intervistuarit deklarojnë se kanë më pak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë krahasuar me rastet e korrupsionit të nivelit të ulët (me një diferencë prej 11 pikë përqindje). Shumica e të anketuarve, ose më shumë se 6 në 10 (62%) ose nuk kanë besim (39%) ose nuk kanë aspak besim (23%) në ndjekjen e rasteve të korrupsionit të ulët, ndërsa 36% të intervistuarve kanë besim të madh (6%) ose besim (30%). Për ndjekjen e korrupsionit të nivelit të lartë, 73% e të anketuarve ose nuk kanë besim (41%) ose nuk kanë aspak besim (32%), ndërkohë që rreth 25% e të anketuarve kanë besim të madh (5%) ose kanë besim (20%).

Të intervistuarit janë pyetur përmes një pyetjeje të hapur të identifikojnë institucionin më të korruptuar në Shqipëri për 2017. 1,373 të anketuar i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. 21% e tyre konsiderojnë Gjykatat si më të korruptuarat të ndjekuar nga Qeveria (16%), Institucionet e Shëndetit Publik (14%) dhe Parlamenti (9%).

Përballja personale me korrupsionin


Pasi janë pyetur për perceptimet e tyre mbi korrupsionin, të intervistuarit janë pyetur për përballjet e tyre personale me fenomenin për të parë se sa prej tyre kanë qenë dëshmitarë të një rasti korruptiv, apo nëse kanë paguar ndonjë ryshfet gjatë 2017.

Të dhënat tregojnë një mospërputhje të dukshme midis perceptimeve mbi përhapjen e korrupsionit dhe përvojave personale të përballjes me fenomenin.

Së pari, shumica e të anketuarve mohojnë të kenë qenë dëshmitar të një rasti korruptiv tek qeverisja e tyre vendore (79%) apo edhe në qeverinë qendrore (85%). Vetëm 21% e të anketuarve deklarojnë se kanë qenë dëshmitarë të paktën të një rasti korrupsioni në qeverisjen e tyre vendore, krahasuar me 15% për qeverisjen qendrore. Shifrat për 2017 tregojnë për një rritje krahasuar me 15% dhe 10% që kanë qenë respektivisht në 2016.

Fig. 23

Përballja personale me korrupsionin 2017



Baza: Për qeverisjen qendrore N =1638, për qeverisjen vendore N =1639

Më pas, të anketuarit janë pyetur nëse gjatë vitit të kaluar, kanë pasur ndonjë kontakt me institucionet në nivel vendor dhe qendror për të marrë ndonjë shërbim. Ata të cilët kanë deklaruar se kanë marrë shërbime, janë pyetur më tej nëse kanë paguar ryshfet. 35% (n=566) e të anketuarve kanë marrë shërbime nga institucione publike në nivel qendror në 2017 (25% në 2016). Nga ata që kanë marrë shërbime nga administrata qendrore gjatë 2017, 33% (n=183) raportojnë se kanë paguar ryshfet për marrjen e shërbimit (26% në 2016).

Fig. 24


A keni marrë të paktën një shërbim nga institucionet publike në qeverisjen qendrore 2017?



Baza: N=1630

Fig. 25

Nëse po, a paguat ryshfet për marrjen e shërbimit?




Baza: N=561

Më shumë se gjysma ose 56% e të anketuarve (n=920) deklarojnë se kanë marrë të paktën një nga shërbim nga institucionet publike në qeverisjen vendore në 2017 (52% në 2016). Prej tyre që kanë marrë shërbime, 32% (n=293) raportojnë se kanë paguar ryshfet (29% në 2016).

Fig. 26


A keni marrë të paktën një shërbim nga institucionet publike në qeverisjen vendore 2017?



Baza: N=1633

Fig. 27

Nëse po, a paguat ryshfet për marrjen e shërbimit?



Baza: N=916

Të pyetur mbi arsyet për pagesën e ryshfeteve, 51% e të anketuarve (n=171) deklarojnë se kanë paguar ryshfet sepse iu është kërkuar një gjë e tillë. Rreth 25% (n=84) deklarojnë se kanë paguar ryshfet në shenjë mirënjohjeje për shërbimet e marra, ndërsa 24% e të anketuarve (n=80) thonë se kanë paguar ryshfet në mënyrë që të marrin shërbime më të mira herës tjetër.

Më pas të anketuarit të cilët kanë pranuar se kanë paguar ryshfet gjatë 12 muajve të fundit, u pyetën nëse e kanë raportuar fenomenin tek zyrtarët/institucionet respektive. Vetëm 3% (n=10) e tyre kanë deklaruar se e kanë raportuar ryshfetin, ndërsa shumica (97% ose n=331) e të intervistuarve deklarojnë se nuk e kanë raportuar këtë praktikë.


Të pyetur mbi arsyet pas mos raportimit, shumica ose 37% e të anketuarve (n=122) thonë se ryshfeti është praktikë e zakonshme, të ndjekur nga një 33% tjetër (n=111), të cilët mendojnë se është e kotë të raportosh sepse askush nuk i kushton rëndësi. 13% e të anketuarve (n=42) nuk kanë raportuar për shkak të frikës nga pasojat e raportimit.

4.4 NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKË

Në një shkallë nga 1 (politika nuk ndikon aspak) deri në 5 (politika ndikon jashtëzakonisht shumë), të anketuarit u pyetën sesa ndikojnë interesat politike në axhendën e një liste institucionesh. 72% e të anketuarve perceptojnë Gjykatat si më të prekshme ndaj ndikimit politik, ndjekur nga Prokuroria me 69% dhe Policia e Shtetit me 49%. Nga ana tjetër, Institucioneve Fetare perceptohen si më të pavarurat nga ndikimi politik (9%), të ndjekura nga Organizatat e Shoqërisë Civile (26%).

Fig. 28

Ndikimi politik në punën e institucioneve 2017



4.5 ANGAZHIMI QYTETAR


Studimet e kryera në komunitetet shqiptare tregojnë për një nivel të ulët të angazhimit qytetar në vendimmarrje. Disa nga shpjegimet fokusohen tek trashëgimia komuniste e qeverisjes së centralizuar, mungesa e besimit tek autoritetet vendore dhe qendrore dhe pakënaqësia me rritjen e pabarazive (Dauti, 2017, Partnerët Shqipëri, 2013, IDM, 2010). Në këtë sondazh, ne dallojmë midis angazhimit të qytetarëve në nivel qendror dhe lokal. Për të shqyrtuar angazhimin e qytetarëve, pyetjet u përqëndruan në mundësitë për të marrë pjesë në vendim-marrje, pjesëmarrjen në proceset dhe takimet konsultuese, angazhimin në punën vullnetare dhe pjesëmarrjen në demonstrime / tubime dhe nënshkrimin e peticioneve. Të anketuarve u është kërkuar gjithashtu të raportojnë për arsyet pas mos-pjesëmarrjes së tyre në takimet e konsultimeve.

Pjesëmarrja në vendimmarrjen e institucioneve publike

28% e të anketuarve raportojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike në nivel qendror. Ndërkohë, 72% raportojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme. Një përqindje më e madhe (36%) raporton se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel lokal. 64% raportojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme.

Fig. 29

Mundësitë për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse 2017



Baza: N = 1634


Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se ata kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në nivelin qendror dhe vendor nëse kishin nivele të larta arsimimi, jetonin në zona urbane dhe ishin të punësuar në sektorin publik. Të anketuarit më të rinj në moshë ishin më të prirur të raportonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen si në nivel qendror dhe lokal.

Të ftuar për të marrë pjesë në proceset e konsultimit

Vetëm 12% e të anketuarve raportojnë se janë ftuar të marrin pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel qendror. Një përqindje më e madhe, 18%, raportojnë se janë ftuar të marrin pjesë në proceset e konsultimit në nivel vendor.

Fig. 30

A jeni ftuar të merrni pjesë në proceset e konsultimit nga institucionet publike 2017



Base: N = 1635


Të anketuarit me nivel të lartë arsimimi (26%), që jetonin në zonat urbane (22%) dhe ishin të punësuar në sektorin publik (41%) kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel lokal. Të anketuarit më të rinj në moshë ishin gjithashtu më të prirur për të raportuar se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit. I njëjti konkluzion vlen edhe për pjesëmarrjen në proceset e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel qendror.

Pjesëmarrja në proceset e konsultimit

Vetëm 10% e të anketuarve deklaruan se kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara në nivel qendror. 15% e të anketuarve thanë se kanë marrë pjesë në proceset e konsultimeve në nivel vendor.

Fig. 31

Pjesëmarrja në proceset konsultuese 2017



Baza: N = 1632

Të anketuarit të cilët kishin nivele të larta arsimimi (15%) dhe ishin të punësuar në sektorin publik (13%) ishin më të prirur të deklarorin se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimeve në nivel qendror. I njëjti konkluzion vlen edhe për pjesëmarrjen në nivel vendor. Të anketuarit në zonat rurale (12%), krahasuar me ato në zonat urbane (17%), kishin më pak gjasa të raportorin se kishin marrë pjesë në takimet konsultuese në nivel vendor.

Pjesa më e madhe e të anketuarve që kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit kanë raportuar se takimet kanë qenë të organizuara nga bashkia (58%) dhe nga qeveria qendrore (44%). Një përqindje më e vogël (25%) raportoi se kanë marrë pjesë në konsultimet publike të organizuara nga këshilli bashkiak.

Tabela 6 Llojet e takimeve konsultuese

Takim i hapur organizuar nga bashkia	58% (n = 160)
Seanca këshillimi me bashkësinë organizuar nga këshilli bashkiak	25% (n = 69)
Konsultime publike organizuar nga qeveria qendrore	44% (n = 121)
Të tjera (specifiko): *	6% (n = 16)

* Të tjera: Dëgjime publike me partitë politike, kryetarin e fshatit dhe organizatat e shoqërisë civile. Shënim: Pyetja ishte me përgjigje të shumëfishtë; përqindjet mund të mos jenë 100%

Shkaku kryesor që është përmendur për mos-pjesëmarrjen në proceset e konsultimit ishte “nuk besoj tek këto procese konsultuese” (37%). 14% e tyre u shprehën se nuk kanë patur informacion mbi temën që diskutohej.

Table 7 Shkaku që nuk kanë marrë pjesë në takimet konsultuese

Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët	18% (n = 169)
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	37% (n = 344)
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	14% (n = 128)
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit	9% (n = 80)
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	11% (n = 99)
Të tjera (specifiko):	12% (n = 108)

* Të tjera: Jam shumë i vjetër; Nuk jam i përgatitur, Unë mbështes vetëm partinë time, Nuk jam i interesuar për politikën, Nuk më kanë ftuar. Shënim: Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet mund të mos jenë 100%.


Mosbesimi në proceset e konsultuese nuk ndryshon sipas gjinisë, arsimit, zonës (urbane ose rurale), statusit të punësimit dhe sektorit. Të anketuarit më të rinj në moshë (mesatarja=39) shprehnin më shumë mosbesim në proceset e konsultimeve sesa të anketuarit më të vjetër (mesatarja=43).

Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve

39% e të anketuarve raportojnë se buxheti i bashkisë së tyre nuk reflekton prioritetet e qytetarëve. 31% raportojnë se buxheti i reflekton këto prioritetet. 30% raportojnë se ata “nuk e dinë” nëse buxheti pasqyron prioritetet e qytetarëve.

Fig. 32

A i reflekton buxheti i bashkisë tuaj prioritetet e qytetarëve?



Baa: N = 1549


Femrat (36%) kishin më shumë gjasa se meshkujt (25%) të raportonin se “nuk e dinin” nëse buxheti i bashkisë pasqyron prioritetet e qytetarëve. Të anketuarit me nivele të ulëta të arsimit (arsimi i detyrueshëm ose më i ulët) (41%) dhe të papunët (42%) ishin më pak të prirur të vlerësonin se buxheti pasqyron prioritetet e qytetarëve. Të anketuarit ishin më të prirur të deklaronin se buxheti pasqyron prioritetet e qytetarëve nëse ishin të punësuar në sektorin publik (52%).

Deklaratat për përfshirjen e qytetarëve

78% e të anketuarve janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën “Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq (72% në vitin 2016).” 40% janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën “Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet në përgjithësi merren në konsideratë.” 67% janë dakord ose janë plotësisht dakord me deklaratën “Dëgjesat publike lokale janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet bashkiake”.

Fig. 33

Deklaratat për përfshirjen e qytetarëve 2017



Baza: N = 1632


Në vitin 2016, 54% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën “Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet merren në konsideratë”. Në 2017, përqindja ishte 40. Një trend i kundërt vihet re për deklaratën “Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale me ndikim të kufizuar në vendimet bashkiake”. Në 2016, 57% e të anketuarve pjesëmarrës në studim ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë deklaratë. Në 2017 përqindja ishte 67.

Pjesëmarrja në një demonstrim/tubim ose nënshkrimi i një peticioni

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 80%, raportojnë se nuk kanë marrë pjesë në demonstrata/tubime ose kanë nënshkruar një peticion gjatë vitit 2017. Të anketuarit më të rinj në moshë (mesatarja=37) janë më të prirur të raportojnë se kanë marrë pjesë në një demonstrim/tubim ose kanë nënshkruar një peticion.

Fig. 34

A keni marrë pjesë në një demonstrim/ tubim apo keni nënshkruar një peticion gjatë vitit 2017?



Baza: N = 1637

Arsyeja kryesore për pjesëmarrjen në demonstrim/tubim ose nënshkrimin e një peticioni ishte interesi i përbashkët i komunitetit.

Tabela 8 Arsyetja për pjesëmarrje në demonstrim/tubim ose nënshkrimin e një peticioni 2017

Interesi personal	12% (n = 41)
Interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj	51% (n = 166)
Militantizmi (për mbështetje politike)	17% (n = 56)
Presioni i shokëve/të njohurve	2% (n = 5)
Kombinim i më shumë se një arsyeje	17% (n = 55)
Të tjera (specifiko)*	2% (n = 5)

*Të tjera: Interesi kombëtar, çështje që lidhen me sistemin arsimor


Shënim: Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet mund të mos jenë 100%.

Dëshira për t'u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit

75% e të anketuarve raportojnë se janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Ndërkohë, 25% e tyre shprehen se nuk janë të gatshëm të merren me punë vullnetare.

Fig. 35

A jeni të gatshëm të angazhoheni në punë vullnetare për të mirën e komunitetit tuaj 2017?



Baza: N = 1635

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare nëse kishin një nivel të lartë arsimimi (88%) dhe ishin të punësuar në sektorin publik (88%). Të anketuarit më të rinj në moshë (mesatarja=39) ishin më të prirur për t'u treguar të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare.


4.6 KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Reagimet (feedback) e rregullta qytetare mbi cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike kanë rëndësi të veçantë në vendet në tranzicion, ku marrëdhëniet midis politikëbërësve, ofruesve të shërbimeve dhe qytetarëve kanë pësuar transformim si rrjedhojë e reformave të ofrimit të shërbimeve duke vënë në qendër qytetarin. Në këtë kontekst, Sondazhi i Opinionit kishte për qëllim të maste nivelin e kënaqshmërisë qytetare ndaj shërbimeve publike të ofruara nga një numër institucionesh publike në 12 muajt e fundit. Shërbimet publike të zgjedhura janë ato që qytetarët marrin çdo ditë (p.sh. transport publik, furnizim me ujë të pijshëm), ose mjaft shpesh (p.sh. shërbime shëndetësore, shërbime komunale etj.) të ofruara si nga qeveria qendrore dhe ajo vendore.

Në mënyrë të veçantë, pyetjet u përqëndruan në kënaqshmërinë me shërbimet publike, përdorimin e shërbimeve publike, raportimi i ankesave tek bashkitë përkatëse, përgjigjshmërinë e institucioneve, cilësinë e shërbimeve sociale dhe sigurinë publike. Një

Fig. 36

Satisfaction with public services 2017



gjetje interesante është se 49% e të anketuarve kanë raportuar se nuk ndihen të sigurt dhe pjesa më e madhe ia atribuojnë pasigurinë kriminalitetit, shëndetësisë pa cilësi dhe standard, pasigurisë në punë dhe padrejtësisë. Krahasuar me Sondazhin e Opinionit të vitit 2016, të anketuarit u pyetën nëse i kishin përdorur shërbimet publike gjatë vitit. Pastaj u bënë krahasime midis atyre që kishin përdorur shërbimet publike dhe atyre që nuk i kishin përdorur ato. Krahasimet u kryhen gjithashtu në bazë të karakteristikave në nivel individual, si gjinia, moshë, arsimit, zona (urbane kundrejt rurale), statusi i punësimit dhe sektori i punësimit.

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

Shërbimet publike që janë vlerësuar më mirë nga më shumë se gjysma e të anketuarve përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm (56%), shërbimet e pastrimit (57%), shërbimet e emergjencave (53%) dhe shërbimet e arsimit publik (54%). Shërbimet publike që janë vlerësuar më pak nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë shërbimet e punësimit (74%) dhe gjykatat (73%) të ndjekura nga shërbimet e shëndetit publik (57%) dhe shërbimet sociale (55%). Të njëjtat trende janë vënë re edhe në 2016. Shërbimet publike që u vlerësuan më pak nga më shumë se 50% e të anketuarve në 2016 ishin: shërbimet e punësimit (78%), shërbimet e gjyqësorit (66%), shërbimet e mirëqenies sociale (60%) dhe shërbimet e shëndetit publik (53%).

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportojnë se ishin të pakënaqur me shërbimet e shëndetit publik nëse kishin nivel të ulët arsimimi (65%), ishin të papunë (63%) dhe punonin në sektorin privat (54%). Një përqindje më e madhe e individëve që i kanë përdorur shërbimet e shëndetit publik gjatë 2017 raportojnë se ishin shumë të pakënaqur. 21% e të anketuarve që i kanë përdorur shërbimet shëndetësore raportuan se ishin “shumë të pakënaqur”. Përqindja për ata që nuk i kanë përdorur shërbimet shëndetësore ishte 12.

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportojnë se ishin të pakënaqur me shërbimet e arsimit publik nëse ishin të rinj, kishin nivele të ulta arsimimi (50%), jetonin në zonat rurale (46%) dhe ishin të papunë (49%). Të anketuarit të cilët raportuan se i kanë përdorur shërbimet e arsimit publik ishin më të prirur të ishin “shumë të pakënaqur”. Në veçanti, 14% e të anketuarve të cilët kanë raportuar se kanë përdorur shërbimet e arsimit publik raportojnë se ishin “shumë të pakënaqur”. Ndërkohë, përqindja e atyre që nuk kanë përdorur shërbimet e arsimit publik është 8.

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportojnë se ishin të pakënaqur me transportin publik nëse ishin më të mëdhenj në moshë dhe të papunë (54%). Të anketuarit të cilët e kanë përdorur transportin publik gjatë 2017 ishin më të prirur të ishin “shumë të pakënaqur”. Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportojnë se ishin të pakënaqur me shërbimet sociale nëse kishin nivele të ulta arsimit dhe ishin të papunë. Të anketuarit që i kanë përdorur shërbimet sociale kishin më shumë gjasa të ishin “shumë të pakënaqur”. Të anketuarit në zonat rurale (64%), krahasuar me ato në zonat urbane (63%), kishin më pak gjasa të raportojnë se ishin të kënaqur me shërbimin e pastrimit të rrugëve. Të anketuarit e përfshirë

në sektorin privat (51%), krahasuar me ato të përfshirë në sektorin publik (64%), kishin më pak gjasa të ishin të kënaqur me shërbimet e licencimit/lejeve/regjistrimit të biznesit.

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të ishin “shumë të pakënaqur” me gjykatat dhe shërbimet e institucioneve të gjyqësorit, nëse ata i kanë përdorur këto shërbime. 56% e të anketuarve që kanë përdorur shërbimet e institucioneve të gjyqësorit kanë raportuar se janë “shumë të pakënaqur”. 37% e të anketuarve që nuk kanë përdorur shërbime të tilla kanë raportuar se “ishin shumë të pakënaqur”.

Shërbimet publike të përdorura më shpesh janë: furnizimi me ujë, transporti publik dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor. Të anketuarit që kanë përdorur shërbimet publike kanë nivele më të larta pakënaqësie.

Tabela 9 Përdorimi i shërbimeve publike 2017

Shërbimet e shëndetit publik	73% (n = 1,118)
Shërbimet e arsimit publik	46% (n = 707)
Transporti publik	76% (n = 1,150)
Shërbimet sociale	42% (n = 634)
Shërbimet e punësimit	46% (n = 702)
Shërbimet e emergjencave	23% (n = 354)
Shërbimet e pastrimit	51% (n = 767)
Licensimi i bizneseve, lejet, regjistrimi	15% (n = 221)
Gjykatat dhe shërbimet e institucioneve të gjyqësorit	11% (n = 159)
Furnizimi me ujë të pijshëm	80% (n = 1,186)
Shërbimet e policisë	22% (n = 327)

Paraqitja e ankesave


15% e të anketuarve raportojnë se kanë dorëzuar një ankesë pranë institucioneve përkatëse në lidhje me një shërbim të marrë.

Të anketuarit ishin më të prirur të paraqesnin një ankesë nëse kishin nivele të larta të arsimit (18%) dhe ishin të punësuar (18%).

37% e të anketuarve raportuan se ankesa e tyre është adresuar, ndërsa një përqindje më e lartë (44%), raportojnë se ankesa e tyre nuk është adresuar. 19% nuk janë në dijeni nëse u është adresuar ankesa.

Fig. 37


A keni paraqitur ndonjë ankesë tek institucionet e mësipërme, për një shërbim të marrë 2017?



Baza: N = 1639

Fig. 38

Nëse po, a është adresuar ankesa juaj?



Baza: N = 241


Anketuesit kishin më shumë gjasa të raportonin që ankesa e tyre ishte adresuar nëse ishin të punësuar (40%).

Institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat e qytetarëve

47% e të anketuarve raportojnë se institucionet nuk “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat e qytetarëve. Përqindja e të anketuarve që raportojnë të kundërtën - institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë siç duhet ankesat e qytetarëve - është 29.

Fig. 39

A mendoni se institucionet "i dëgjojnë" dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët?



Baza: N = 1599


Të anketuarit kanë më shumë gjasa të raportojnë se institucionet nuk “i dëgjojnë” dhe adresojnë siç duhet ankesat e qytetarëve nëse kishin nivel të ulët arsimimi (57%) dhe ishin të papunë në momentin e intervistës (55%).

Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia

Më shumë se gjysma e të anketuarve (53%) raportojnë se cilësia e shërbimeve sociale të ofruara në bashkitë e tyre nuk ka ndryshuar gjatë 2017. 33% raportojnë se është përmirësuar. 14% raportojnë se është përkeqësuar.

Fig. 40

Ndryshimet në cilësinë e shërbimeve sociale 2017




Baza: N = 1620

Siguria

51% e të anketuarve shprehen se nuk ndihen të sigurt në jetën e tyre të përditshme. Ndërkohë, 49% raportojnë se nuk ndihen të sigurt.

Fig. 41

A ndjeheni të sigurt në jetën tuaj të përditshme 2017?



Baza: N = 1615

Pjesa më e madhe e të anketuarve raportojnë si faktorë kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë kriminalitetin (58%), shëndetësia pa cilësi e standard (30%), pasiguria për punën (42%) dhe drejtësia jo e plotë (32%).

Tabela 10 Faktorë kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë

Kriminaliteti	58% (n = 459)
Trafiku	11% (n = 90)
Ndotja e mjedisit	12% (n = 95)
Shëndetësia pa cilësi e standard	30% (n = 242)
Pëdorimi i lëndëve narkotike	23% (n = 181)
Pasiguria për punën	42% (n = 331)
Dhuna në familje	15% (n = 121)
Drejtësia jo e plotë	32% (n = 257)
Politika	29% (n = 230)
Pabarazia në pasuri	23% (n = 183)
Diskriminimi në bazë të gjinisë, besimit fetar etj.	5% (n = 36)
Mungesa e lirisë së fjalës	5% (n = 39)
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtës kur raportohen kundravajtjet	6% (n = 49)

Baza: N = 795

Shënim: Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet mund të mos jenë 100%.

4.7 PERFORMANCA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Për të matur performancën e institucioneve publike, të anketuarve iu kërkua që të rendisin 11 institucione nga 1 (performanca e shkëlqyer) në 5 (performanca shumë e dobët). Një gjetje e qëndrueshme në sondazhet e mëparshme të opinionit është se shqiptarët e perceptojnë performancën e Institucioneve Fetare dhe të Ushtrisë si më pozitive se institucionet e tjera. Ndërkohë, performanca e Gjykatave, Partive Politike dhe Parlamentit shihet si më negative sesa institucionet e tjera. Rezultatet e Sondazhit të Opinionit të këtij viti ndjekin të njëjtën trajektore.

Duke iu referuar opinioneve të të anketuarve, institucionet me performancë më të ulët janë vlerësuar Gjykatat, Prokuroria, Partitë Politike dhe Parlamenti. Për shembull, 72% e të anketuarve e vlerësojnë performancën e gjykatave si të dobët ose shumë të dobët. 69% e vlerësojnë performancën e Prokurorisë si të dobët ose shumë të dobët. Ndërkohë, 57% e të anketuarve e vlerësojnë performancën e Institucioneve Fetare si shumë të mirë ose të shkëlqyer.

Tabela 11 Performanca e institucioneve (në përqindje)

	Të shkëlqyer	Shumë të mirë	Neutral	Të dobët	Shumë të dobët
Qeveria qendrore	4	24	27	31	15
Qeveria vendore (Bashkia)	4	28	28	29	11
Presidenti	2	12	37	37	12
Parlamenti	2	11	33	39	16
Prokuroria	1	7	24	43	26
Gjykatat	1	6	21	42	30
Policia	5	24	30	28	12
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3	17	52	21	7
Ushtria	10	36	38	11	5
Institucionet fetare	19	38	33	7	4
Partitë politike	2	11	30	37	20

Baza: N = 1635

4.8 TIK (PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË)


TIK mund të jetë një mjet efektiv në afrimin e qytetarëve dhe autoriteteve. Megjithatë, kjo varet nga cilësia e burimeve elektronike dhe masa në të cilën qytetarët i shfrytëzojnë këto burime. Pyetjet u përqëndruan në njohuritë e qytetarëve rreth faqes së internetit të bashkisë së tyre dhe shërbimeve elektronike të ofrurara. Të anketuarit gjithashtu u pyetën nëse ata e kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë, mënyrën se si e kanë përdorur atë dhe cilësinë e faqes së internetit.

Bashkia ka një faqe interneti

39% e të anketuarve raportojnë se bashkia e tyre ka një faqe interneti. 52% raportojnë se nuk e dinë nëse bashkia ka një faqe interneti. Të anketuarit kishin më pak gjasa të raportonin se ishin në dijeni që bashkia e tyre ka një faqe interneti nëse kishin nivel të ulët të arsimit (12%), jetonin në zonat rurale (32%) dhe ishin të papunë (30%).

Fig. 42

A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti?




Baza: N = 1640

Bashkia ofron shërbime elektronike

Vetëm gjysma e të anketuarve raportojnë se janë të informuar nëse bashkia e tyre ofron shërbime elektronike. 42% nuk e dinë nëse bashkia ofron shërbime elektronike. Krahasuar me vitin 2016, një përqindje më e madhe ka raportuar se bashkia ofron shërbime elektronike. Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se bashkia ofron shërbime elektronike nëse kishin nivel të lartë të arsimit (57%) dhe ishin të punësuar në sektorin publik (61%).

Fig. 43

Nëse po, a jeni në dijeni nëse Bashkia ofron shërbime elektronike?




Baza: N = 644

Përdorimi i faqes së internetit të bashkisë

67% e të anketuarve që janë në dijeni të faqes së internetit të bashkisë së tyre deklarojnë se nuk e përdorin faqen e internetit të bashkisë. Në vitin 2016, 41% e të anketuarve raportuan se e përdornin faqen e internetit. Të anketuarit me nivel më të lart të arsimimit (41%) dhe të punësuar në sektorin publik (51%) kishin më shumë gjasa të raportonin se përdornin faqen e internetit të bashkisë. Njohuritë dhe përdorimi i teknologjisë kishin një marrëdhënie pozitive me moshën.

Fig. 44

A e përdorni faqen e internetit të bashkisë?



Baza: N = 638

Mënyrat e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

Pjesa më e madhe e të anketuarve raportojnë se e përdorin faqen e bashkisë për të marrë informacion (34%), ndjekur vendimet e këshillit (16%) dhe për të marrë shërbime elektronike (16%).

Tabela 12 Mënyrat e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

Kontrolloj programet / aktivitetet në bashkinë time	34% (n = 128)
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	16% (n = 59)
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak	7% (n = 26)
Për të marrë shërbime përmes internetit	16% (n = 60)

Për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	9% (n = 32)
Të tjera: *	3% (n = 12)


Tjetër: Për të marrë informacione rreth biznesit

Vlerësimi i cilësisë së faqes së internetit të bashkisë

Pjesa më e madhe e të anketuarve e vlerësojnë cilësinë e faqes së internetit për sa i përket informacionit të ofruar si: të saktë (91%), të plotë (79%) dhe të përditësuar vazhdimisht (72%).

Fig. 45

Cilësia e informacionit në faqen e internetit të bashkisë




Baza: N = 205

Në të njëjtën linjë, pjesa më e madhe e të anketuarve vlerësojnë shërbimet elektronike të bashkisë si funksionale (90%), të thjeshta në përdorim (86%), dhe që përfshijnë mekanizma “feedback-u” (88%).

Fig. 46

Cilësia e shërbimeve elektronike




4.7 GJINIA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Shoqërinë shqiptare e karakterizon një ndarje tradicionale e roleve gjinore. Zakonisht janë gratë ato që bëjnë larjen dhe hekursjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë, gatimin dhe larjen e enëve. Dy punët e shtëpisë ku burrat kanë gjasa të jenë më të angazhuar se gratë lidhen me riparimet në shtëpi dhe pagimin e faturave. (UNDP, 2016). Për të eksploruar qëndrimet ndaj barazisë gjinore, të anketuarit raportuan qëndrimet e tyre mbi tre deklaratat. Pyetjet gjithashtu u përqendruan në njohuritë dhe qëndrimet e të anketuarve ndaj grave në vendimmarrjen lokale. Për të shqyrtuar aspekte të tjera të përfshirjes sociale, të anketuarit raportuan nëse janë trajtuar ndryshe në bazë të karakteristikave të tyre gjatë 2017, duke përfshirë gjininë, moshën, etninë, orientimin seksual apo aftësinë e kufizuar.

65% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën “Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave”. Gratë kishin më pak gjasa që të pajtoheshin me këtë deklaratë sesa burrat. 60% e grave dhe 71% e meshkujve janë dakord ose shumë dakord me deklaratën. Të anketuarit me arsim të detyrueshëm ose më të ulët (11%), kishin më pak gjasa të pajtoheshin me deklaratën krahasuar me ata me nivele më të larta të arsimit (34%). Përgjigjet nuk ndryshonin sipas zonës, statusit të punësimit, sektorit të punësimit apo moshës. Në vitin 2016, 55% e burrave dhe 39% e grave ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën. Në vitin 2017, këto përqindje ishin përkatësisht 71 dhe 60.

Fig. 47

Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave




74% e të anketuarve ishin dakord dhe plotësisht dakord me deklaratën “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike.” Gratë kishin më pak gjasa se burrat të binin dakord me deklaratën. 71% e grave dhe 79% e burrave ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën. Të anketuarit me arsim të detyrueshëm ose më të ulët (13%) kishin më pak gjasa të pajtoheshin me deklaratën në krahasim me ata me nivel më të lartë arsimimi (34%). Përgjigjet nuk ndryshojnë sipas zonës, statusit të punësimit ose moshës. 79% dhe 73% e të anketuarve të përfshirë në sektorin privat dhe sektorin publik respektivisht janë dakord ose plotësisht dakord me këtë deklaratë. Në vitin 2016, 63% e burrave dhe 55% e grave ishin dakord me deklaratën. Në vitin 2017, këto përqindje ishin përkatësisht 79 dhe 71.

74% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën “Në Shqipëri nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.” Gratë kishin më pak gjasa që të pajtoheshin me deklaratën se sa burrat. 69% e grave dhe 80% e burrave ishin dakord me deklaratën. Të anketuarit me arsim të detyrueshëm ose më të ulët (76%) kishin më pak gjasa të pajtoheshin me deklaratën në krahasim me ata me nivel më të lartë arsimimi (85%). Përgjigjet nuk ndryshojnë sipas zonës, statusit të punësimit ose moshës. Në vitin 2016, 66% e burrave dhe 56% e grave ishin dakord me deklaratën. Në vitin 2017, këto përqindje ishin përkatësisht 80 dhe 69.

Fig. 48


Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike



Baza: N = 1619

Fig. 49

Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave



Baza: N = 1614

Trajtimi nga institucionet

88% e të anketuarve raportojnë se nuk janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës civil për shak të karakteristikave të tyre si gjinia, mosha, përkatësia etnike, orientimi seksual apo aftësia e kufizuar. Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se ata ishin trajtuar ndryshe nëse kishin nivele të ulta arsimimi (21%), jetonin në zonat urbane (14%) dhe ishin të papunë (14%). Gratë (14%) kishin më shumë gjasa se burrat (10%) të raportonin se ishin trajtuar ndryshe. Nga 192 të anketuar që kanë raportuar se janë trajtuar ndryshe, 42% ishin meshkuj dhe 58% ishin femra.

Tabela 13 Trajtimi nga institucionet 2017

Jam trajtuar ndryshe	12% (n=192)
Gjinia	(n = 51)
Mosha	(n = 48)
Përkatësia etnike	(n = 45)
Orientimi seksual	(n = 5)
Aftësia e kufizuar	(n = 23)
Të tjera:*	(n = 20)
Nuk jam trajtuar ndryshe	88% (n = 1430)


*Të tjera: besimi politik, situata ekonomike (varfëria) dhe prejardhja rurale.

Më shumë gra në këshill bashkiak

63% e të anketuarve thonë se nuk e dinë nëse ka ose jo më shumë gra në këshillin e tyre bashkiak. Përgjigjet ndryshojnë sipas arsimit, zonës, statusit të punësimit dhe sektorit të punësimit të të anketuarve. Të anketuarit që kishin nivele të ulëta arsimit (73%), jetonin në zonat rurale (65%) dhe ishin të punësuar në sektorin privat (58%) kishin më shumë gjasa të raportonin se nuk e dinin nëse ka më shumë gra në këshillin e tyre bashkiak.

Fig. 50

A jeni në dijeni nëse Këshilli Bashkiak (ku ju banoni) ka më shumë gra, krahasuar me vitin 2015?




Baza: N = 1628

Kënaqshmëria me numrin e grave në këshillin bashkiak

7% e të anketuarve thonë se nuk janë të kënaqur me numrin aktual të grave në këshillin bashkiak. 26% thonë se janë të kënaqur. Gratë kishin më pak gjasa se burrat të raportonin se janë të kënaqura me numrin e grave në këshillin bashkiak. Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin të kënaqur me numrin e grave në këshillin bashkiak nëse kishin nivele të larta arsimimi (34%), jetonin në zonat rurale (29%) dhe ishin të punësuar në sektorin publik (43%).

Fig. 51

A jeni të kënaqur me numrin aktual të grave në këshillin tuaj bashkiak?




Baza: N = 1439

Njësoj të aftë të mbajnë poste publike

83% e të anketuarve thonë se “burrat dhe gratë janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike”. 9% thonë se gratë nuk janë aq të afta sa burrat të mbajnë poste publike. Gratë kanë më shumë gjasa se burrat të raportojnë se “janë po aq të afta që të mbajnë poste publike”. Të anketuarit kishin më pak gjasa të pajtoheshin me deklaratën nëse kishin nivele të ulëta të arsimimit (76%). Përgjigjet nuk ndryshojnë sipas zonës, statusit të punësimit apo sektorit të punësimit.

Fig. 52


A mendoni se burrat dhe gratë janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike?



Basa: N = 1626

Fig. 53

A mendoni se burrat dhe gratë janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike, sipas gjinisë?




Ndikimi pozitiv i grave në qeverisjen vendore

69% e të anketuarve thonë se rritja e numrit të grave në këshillin e tyre bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen lokale. Ndërkohë, 17% thonë se rritja e numrit të grave nuk do të ketë ndikim pozitiv. 14% thonë se nuk e dinë. Gratë (81%) janë më të prirura se burrat (58%) të raportojnë se rritja e numrit të grave në këshillin bashkiak do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen lokale. Përgjigjet nuk ndryshojnë sipas zonës, statusit të punësimit apo sektorit të punësimit.

Fig. 54

A mendoni se një numër më i madh i grave në Këshillin bashkiak do të ketë një impakt pozitiv në qeverisjen vendore?



Baza: N = 1631

Referencat

- Andvig, J. & Fjelstad, O. (2001). *Corruption: A review of contemporary research*, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights. Report R 2001:7. Bergen, Norway.
- Dauti, M. (2017). *The impact of decentralization on participation in formal organizations in Albania: Lessons for community-based interventions*. *International Social Work*, 60(6), 1523-1536.
- Hetherington, M. J. (1998). *The political relevance of political trust*. *American Political Science Review*, 92(4), 791-808.
- Institute for Democracy and Mediation. (2010). *Civil society index for Albania: In search of citizens & impact*. Tirana, Albania: IDM.
- Levi, M. & Stoker, L. (2000). *Political trust and trustworthiness*. *Annual Review of Political Science* 3(1), 475-507.
- OECD (2013), *Government at a Glance 2013*, OECD Publishing. http://dx.doi.org/10.1787/gov_glance-2013-en
- Partners Albania. (2013). *Participation of citizens and civil society in decision making*. Tirana, Albania: Partners Albania.
- World Bank. (2012). *Public office private interests: Accountability through income and asset disclosure*. Washington DC: World Bank.
- UNDP. (2016). *Public perceptions and attitudes toward gender equality in Albania*. Tirana, Albania: UNDP.

SHTOJCA 1: NJËSITË ADMINISTRATIVE

Nr.	Zona	Qendra Bashkiake	Njësia Administrative	Nr i Pyetësorëve
1	Berat	Berat	Otlak	27
		Ura Vajgurore	Poshnjë	27
		Kuçovë	Kozarë	27
		Skrapar	Qendër Skrapar	27
		Poliçan	Tërpan	27
2	Dibër	Peshkopi	Maqellarë	27
		Bulqizë	Ostren	27
		Burrel	Ulëz	27
		Klos	Xibër	27
3	Durrës	Durrës	Ishëm	27
		Shijak	Maminas	27
		Krujë	Fushë Krujë	27
4	Elbasan	Elbasan	Labinot	27
		Cërrik	Gostimë	27
		Belsh	Grekan	27
		Peqin	Përparim	27
		Gramsh	Pishaj	27
		Librazhd	Hotolisht	27
		Përrenjas	Qukës	27

Nr.	Zona	Qendra Bashkiake	Njësia Administrative	Nr i Pyetësorëve
5	Fier	Fier	Cakran	27
		Roskovec	Kuman	27
		Patos	Sharrëz	27
		Lushnjë	Golem	27
		Divjakë	Grabian	27
		Ballsh	Selitë	27
6	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Antigonë	27
		Libohovë	Qendër Libohovë	27
		Memaliaj	Memaliaj Fshat	27
		Përmet	Petran	27
		Këlcyrë	Kelcyrë Fshat	27
		Tepelenë	Dukat	27
		Dropull i Sipërm	Dropull i Poshtëm	27
7	Korçë	Korçë	Vithkuq	27
		Maliq	Libonik	27
		Pustec	Pustec fshat	27
		Ersekë	Novoselë	27
		Bilisht	Hoçisht	27
		Pogradec	Udënisht	27
8	Kukës	Kukës	Bicaj	27
		Krumë	Golaj	27
		Bajram Curri	Margegaj	27

Nr.	Zona	Qendra Bashkiake	Njësia Administrative	Nr i Pyetësorëve
9	Lezhë	Lezhë	Shëngjin	27
		Rrëshen	Rubik	27
		Laç	Milot	27
10	Shkodër	Shkodër	Rrethinat	27
		Koplik	Gruemirë	27
		Pukë	Gjegjan	27
		Vau Dejës	Bushat	27
		Fushë Arrëz	Fierzë	27
11	Tiranë	Tiranë	Petrelë	27
		Kamëz	Paskuqan	27
		Vorë	Bërshullë	27
		Kavajë	Luz i vogël	27
		Rrogozhinë	Kryevidh	27
12	Vlorë	Vlorë	Orikum	27
		Selenicë	Vllahinë	27
		Himarë	Lukovë	27
		Sarandë	Ksamil	27
		Konispol	Xarrë	27
		Finiq	Livadhja	27

SHTOJCA 2: KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Gjinia					
Meshkuj	45%	49%	50%	57%	51%
Femra	55%	50%	50%	43%	49%
Grupmoshat					
18-25	14%	23%	23%	18%	19%
26-35	14%	22%	25%	23%	23%
36-45	14%	18%	16%	19%	19%
46-55	19%	18%	17%	18%	19%
55-65	20%	10%	11%	13%	11%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%
Niveli i arsimit					
Të pashkolluar + vetëm fillore	1%	1%	2%	0%	5%
Arsimi bazë	14%	15%	14%	25%	17%
Shkollë e mesme	40%	41%	40%	51%	50%
Universitet	44%	42%	43%	24%	28%
Statusi i punësimit					
Të punësuar	40%	46%	45%	43%	46%
Të papunë	20%	25%	28%	35%	34%
Studentë	8%	10%	9%	8%	7%
Pensionistë	26%	9%	11%	12%	12%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%

Shënim: Refuzimet nuk janë përfshirë. Shumatorja e përqindjeve mund të mos jetë 100%.

poshtëshënime

1. *DS nënkupton devijimin standard. Devijimi Standard është një tregues i ndryshueshmërisë, i cili tregon sesi janë shpërndarë rezultatet rreth mesatares aritmetike.*
2. *Nëse individët perceptojnë se qeveria po ndjek objektivat me të cilat ata janë dakord, ata supozohet të besojnë tek qeveria më shumë.*
3. *Si tejçues të informacionit pozitiv dhe negativ që individët marrin rreth qeverisë.*
4. *Tre institucione jo shqiptare, OKB, NATO dhe BE, i janë shtuar listës kryesisht për shkak të shkallës së lartë të përfshirjes së këtyre institucioneve në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të shoqërisë shqiptare.*
5. *Përgjatë raportit, për arsye të analizës, kategoritë (1-2) dhe kategoritë (3-4) të vlerësimeve verbale janë bashkuar në dy kategori të mëdha: prirjen të besojnë dhe nuk prirjen të besojnë.*
6. *% e të anketuarve që shprehin “Kam shumë besim” ose “Kam besim”*
7. *Arsimi bazë këtu nënkupton përfundimin e arsimit të detyrueshëm.*
8. *Gjykatat dhe Prokuroria nuk janë të përfshira në këtë krahasim, duke qenë se u përfshinë për herë të parë këtë vit.*
9. *Kreu III i ligjit*
10. *N përfaqëson numrin e përgjigjeve*
11. *Objektivi 16. Promovimi i shoqërive gjithëpërfshirëse dhe paqësore për zhvillim të qëndrueshëm, garantimi i drejtësisë për të gjithë dhe ngritja e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse. Aksesuar në <http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>*
12. *Staphenhurst, R. Llogaridhënia në Qeverisje, Analizë e Bankës Botërore 4.*
13. *Ligji 45/2015. Aksesuar në <http://autoritetidosjeve.gov.al/baza-ligjore/>*
14. *Të intervistuarve ju është dhënë një përkufizim i detajuar i korrupsionit të vogël (Abuzimi me pushtetin nga ana e zyrtarëve publikë përmes marrjes së rryshfetit për shërbimet e ofruara) dhe të madh (Abuzimi me pushtetin politik nga ana e zyrtarëve të lartë për përfitime personale).*

